

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE DHE DREJTORITË RAJONALE TATIMORE, TATIM PAGUESIT E MËDHENJ, TIRANË, DURRËS, DIBËR, KUKËS, FIER DHE KORÇË “MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE PËR TAKSËN E RENTËS MINERARE”**

Auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore, Tatim Paguesit e Mëdhenj, Tiranë, Durrës, Dibër, Kukës, Fier dhe Korçë “Mbi zbatimin e legjislacionit për Taksën e Rentës Minerare, realizimin e të ardhurave tatimore dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të aktiviteteve që nxjerrin, tregtojnë e eksportojnë minerale e nënprodukte të tyre” për periudhën vitet 2013-2014, u krye përgjatë periudhës 25.03.2015 deri më 20.07.2015.

Raporti përfundimtar i auditimit dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 132, datë 25.09.2015.

Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 286/18, datë 25.09.2015, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, është dërguar “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Nga auditimi i ushtruar në DRT mbi aktivitetin e subjekteve që deklarojnë e paguajnë Taksën Nacionale për Rentën Minerare u konstatua:

- Nga 14 Drejtoritë Rajonale Tatimore të ardhurat për taksën e rentës minerare:

a) Në vitin 2013 vetëm 3 Drejtori kanë realizuar të ardhurat sipas programit, ndërsa 11 Drejtoritë e tjera paraqiten me mosrealizim të theksuar.

b) Në vitin 2014 vetëm 4 Drejtori kanë realizuar të ardhurat sipas programit, ndërsa 10 Drejtoritë e tjera paraqiten me mosrealizim.

-Mos realizimi i kontrolleve fiskale ose tematike me objekt deklarimin e pagesën e taksës kombëtare për rentën Minerare;

-Probleme në deklaramet e të ardhurave të realizuara në pasqyrat financiare ku janë paraqitur shpenzime të panjohura si të njohura duke ndryshuar rezultatin financiar me efekte në llogaritjen dhe pagesën e tatim fitimit

-Në raportet e kontrollit të realizuara në këta subjekte ka mosaplikim të saktë të penaliteteve të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet.

*Sa më sipër trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, është rekomanduar:*

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të analizojë nivelin e ulët të deklarimit të pagesës së Taksës së Rentës Minerare dhe të përfshijë në planifikimin vjetor kontrolle tatimore në DRT-të me objekt Taksën e Rentës Minerare.

*Në vijimësi*

2. Nga auditimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore veçanërisht për subjektet që prodhojnë, përpunojnë e shesin inerte kostatojmë që:

- Për periudhen e audituar viti 2013-2014, në dy DRT nga 41 subjekte gjithsej, 11 prej tyre rezultojnë me humbje dhe subjektet e tjera kanë paraqitur fitim minimal dhe tregues të ulët financiar e fiskal;

-Subjektet që kanë aktivitet të përzier (ndërtim dhe inerte); deklarimi i shitjeve të inerteve në raport me shitjet gjithsej, zë një peshë të vogël; dhe në situacionet e vetë subjektit nuk janë të argumentuar me dokumentacion shoqërues materialet inerte të përdorura (si shpenzime apo vetëm si të ardhura) me influencë në ndryshimin e gjendjeve materiale tek pasqyrat financiare;

Me gjithë ekzistencën e problemeve të mësipërme nuk janë bërë objekt analize e kontrolli në Drejtorinë e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë e Kontrollit Tatimor.

*Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 104-107 të RPA, është rekomanduar:*

Në Drejtorinë Rajonale Tatimore të analizohet niveli i ulët i deklarimit të shitjeve dhe të ardhurave nga Taksa e Rentës Minerare për subjektet që i nënshtrohen kësaj takse dhe të merren masa konkrete për përmirësimin e gjendjes duke ushtruar kontrole tatimore në këta subjekte.

*Në vijimësi*

**3.** Nga auditimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore lidhur me procedurat e ndjekura për verifikimin e pasqyrave financiare dhe planifikimin për kontroll nga Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave u konstatua se, niveli i zbatimit të Udhëzuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 2747/1, datë 05.02.2014 ku përcaktohet: "Të dhënat nga shqyrtimi paraprak i pasqyrave financiare, sidomos për tatimpagues me humbje, normë të ulët rentabiliteti, si dhe tatimpagues të cilat gjykohen për verifikime të mëtejshme të deklarimeve në vend, të evidentohen dhe ti dërgohen për ndjekje të mëtejshme Drejtorisë së Kontrollit Tatimor", paraqitet në nivele të ulëta për subjektet problematikë. Kështu, nuk janë planifikuar dhe kontrolluar subjektet me gjendje më të lartë kreditore, me parregullsi në deklarim, me nivele të larta të detyrimeve të pashlyera.

Në Programet e Kontrollit qoftë edhe në kontrollet e plota, është anashkaluar kontrolli i Taksës së Rentës Minerare ku në asnjë rast nuk është programuar e kontrolluar si pikë e veçantë apo edhe si nënpikë e kontrollit dhe për pasojë edhe kontrollet për këtë taksë kanë rezultuar të paplota e me të meta duke e bërë të pamundur mbledhjen e kësaj takse. Po kështu në nivele shumë të ulta për këta subjekte rezultojnë edhe kontrollet në teren.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 15-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, është rekomanduar:*

-Në Drejtorinë e Përgjithëshme të Tatimeve dhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore, kontrolli i Taksës së Rentës Minerare dhe të subjekteve që paguajnë Rentë Minerare të vlerësohet dhe të programohet në programet e kontrollit si pikë e veçantë si dhe të shtohet edhe kontrolli nga Sektori i Terrenit.

*Në vijimësi*

-Drejtorinë e Vlerësimit të të Ardhurave dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, si dhe Drejtorinë e Mbledhjes së Borxhit në Drejtorinë Rajonale Tatimore, të rrisin bashkëpunimin dhe të dalin me një propozim të përbashkët për subjektet tatimpagues që do të nënshtrohen kontrollit tatimor.

*Në vijimësi*

4. Nga auditimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore rezulton një mungesë e theksuar e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të brendshme të saj, kryesisht Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit me Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, veprime këto që bien ndesh me kërkesat e Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore pjesa e II-të, pika 27, Drejtorinë Rajonale Tatimore.

*Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 15-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, është rekomanduar:*

Drejtorinë Rajonale Tatimore, të marrin masa të plota lidhur me organizimin dhe funksionimin bashkëpunues midis Drejtorive dhe Sektorëve në përbërje të saj, me qëllim rritjen e nivelit të kontrollit dhe të të ardhurave nga çdo tatim dhe taksë e programuar.

***Në vijimësi***

5. Nga auditimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore rezulton një mungesë e theksuar e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të Sistemit Doganor dhe Sistemit Tatimor veçanërisht për marrjen dhe shpërndarjen e informacionit shtesë për vendimet që nxjerrin Degët Doganore për vlerësime në rritjen e vlerës së eksportit dhe të Taksës së Rentës Minerare, mbështetur kjo në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë " Neni 71 pika b dhe në VKM. nr.7, datë 04.01.2012 pika 6.

*Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 77-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, është rekomanduar:*

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore të merren masa për një bashkëpunim më të mirë me strukturat e Sistemit Doganor për marrjen dhe shpërndarjen e informacionit shtesë për vendimet që nxjerrin Degët Doganore, kjo edhe në zbatim të marrëveshjeve të përbashkëta të lidhura midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

***Në vijimësi***

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportit Përfundimtar të Auditimit, i rekomandojmë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore marrjen në shqyrtim të tyre, në lidhje me detyrimet tatimore të pa përlllogaritura dhe të pa kontabilizuar **në shumën 118,832,709 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Nga auditimi në **Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës** i veprimtarisë së subjekteve që deklarojnë e paguajnë Taksën Kombëtare të Rentës Minerare u konstatua së është krijuar një e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 17, datë 20.05.2008 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" me ndryshime, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 "Për Tatimin mbi të Ardhurat".

*Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 24-25, 44-54 dhe 85-88 të RPA, është rekomanduar:*

Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, të marrë masa për të përlllogaritur e kontabilizuar detyrimet tatimore të pa përlllogaritura dhe të pa kontabilizuara **në shumën 27,115,149 lekë nga 3 subjekte**

***Brenda datës 30.12.2015***

**2. Nga auditimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore Kukës** i veprimtarisë së subjekteve që deklarojnë e paguajnë Taksën Kombëtare të Rentës Minerare u konstatua së është krijuar një e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, Udhëzimit nr.17, datë 20.05.2008 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” me ndryshime, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”.

*Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 25-29, 54-69 dhe 88-92 të RPA, është rekomanduar:*

Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës, të marrë masa për të përlllogaritur e kontabilizuar detyrimet tatimore të pa përlllogaritura dhe të pa kontabilizuara **në shumën 24,376,870 lekë nga 7 subjekte** [REDACTED].

***Brenda datës 30.12.2015***

**3. Nga auditimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore Dibër** i veprimtarisë së subjekteve që deklarojnë e paguajnë Taksën Kombëtare të Rentës Minerare u konstatua së është krijuar një e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 17, datë 20.05.2008 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” me ndryshime, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”.

*Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 15-24, 29-44 dhe 77-85 të RPA, është rekomanduar:*

Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, të marrë masa për të përlllogaritur e kontabilizuar detyrimet tatimore të pa përlllogaritura dhe të pa kontabilizuara **në shumën 37,659,103 lekë nga 16 subjekte** [REDACTED].

***Brenda datës 30.12.2015***

**4. Nga auditimi në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë** i veprimtarisë së subjekteve që deklarojnë e paguajnë Taksën Kombëtare të Rentës Minerare u konstatua së është krijuar një e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 17, datë 20.05.2008 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” me ndryshime, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”.

*Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 69-77 dhe 92-95 të RPA, është rekomanduar:*

Drejtoria e Tatimpagueseve të Mëdhenj, Tiranë të marrë masa për të përlllogaritur e kontabilizuar detyrimet tatimore të pa përlllogaritura dhe të pa kontabilizuara **në shumën 11,258,815 lekë nga 5 subjekte** [REDACTED].

***Brenda datës 30.12.2015***

**5. Nga auditimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Tiranë** i veprimtarisë së subjekteve që deklarojnë e paguajnë Taksën Kombëtare të Rentës Minerare u konstatua së është krijuar një e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 17, datë 20.05.2008 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” me ndryshime, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”.

*Sa më sipër trajtuar në faqet nr. 95-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, është rekomanduar:*

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, të marrë masa për të përlogaritur e kontabilizuar detyrimet tatimore të pa përlogaritura dhe të pa kontabilizuara **në shumën 18,254,352 lekë nga 12 subjekte** [REDACTED].

*Brenda datës 30.12.2015*

**6. Nga auditimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë** i veprimtarisë së subjekteve që deklarojnë e paguajnë Taksën Kombëtare të Rentës Minerare u konstatua së është krijuar një e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 17, datë 20.05.2008 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” me ndryshime, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”.

*Sa më sipër trajtuar në faqen nr. 95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, është rekomanduar:*

Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, të marrë masa për të përlogaritur e kontabilizuar detyrimet tatimore të pa përlogaritura dhe të pa kontabilizuar **në shumën 366,420 lekë nga 1 subjekt** [REDACTED].

*Brenda datës 30.12.2015*

#### **D. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkoj Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe Drejtorëve të Drejtorive Rajonale Tatimore, që në vlerësimin e shkeljeve sipas shkallës së përgjegjësisë për punonjësit e atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe që janë aktualisht në sistemin tatimor sipas Drejtorive Rajonale Tatimore, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave për shqyrtimin e dhënien e masave përkatëse disiplinore nga “**vërejtje**” deri në “**Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 1 vjeçare**”, sipas VKM nr. 115, datë 5.3.2014 dhe ligjit nr. 152/2013, për **11 nëpunësit civil** në Drejtorinë Rajonale Tatimore si më poshtë:

#### **Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, per 7 nepunes civil:**

1. [REDACTED], me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit
2. [REDACTED], me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Kontabilitetit
3. [REDACTED], me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor dhe Kontabilitetit

*-Për veprime në kundërshtim me kërkesat; Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë ” i ndryshuar, nenet 49, 115, 116; Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar neni 40; Udhëzimi Nr. 17 datë 20.05.2008 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” me ndryshimet pika 13 Mbajtja e Regjistrimeve; Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” neni 20, 21; Udhëzimin Nr. 5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” Pika 3.5 Shpenzimet e Njohura.*

4. ■■■■■ me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor
5. ■■■■■ me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
6. ■■■■■ me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
7. ■■■■■ me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

*Për veprime në kundërshtim me kërkesat e veprime në kundërshtim me; Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 59,71, 115, 116, 120; ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nenit 33/1; kërkesat e Manualit të Kontrollit miratuar me nr. 5045, datë 22.02.2011; Ligjin nr. 10304 datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” neni 40 pika 2, ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare”, ligjit nr. 10280, datë 20.05.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, VKM nr. 7, datë 04.01.2012 “Për Përcaktimin e Procedurave dhe të Dokumentacionit të Nevojshëm për Arkëtimin e Taksës së Rentës Minerale” pika 6 dhe 7, Shkresës së Ministrisë Financave nr. 16365 datë 17.10.2012 “Për Miratimin e Vlerave Referuese sipas Normativave Teknologjike të produkteve që përdorin minerale nga Komisioni AD HOC mbi Rentën Minerale” pika 1/1.*

#### **Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës per 1 nepunes civil:**

8. ■■■■■ me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

*Për veprime në kundërshtim me kërkesat e veprime në kundërshtim me; Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “ Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë ” i ndryshuar, nenet 59,71, 115, 116, 120; ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nenit 33/1; kërkesat e Manualit të Kontrollit miratuar me nr. 5045, datë 22.02.2011; Ligjin nr. 10304 datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” neni 40 pika 2, ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare”, ligjit nr. 10280, datë 20.05.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, VKM nr. 7, datë 04.01.2012 “Për Përcaktimin e Procedurave dhe të Dokumentacionit të Nevojshëm për Arkëtimin e Taksës së Rentës Minerale” pika 6 dhe 7, Shkresës së Ministrisë Financave nr. 16365 datë 17.10.2012 “Për Miratimin e Vlerave Referuese sipas Normativave Teknologjike të produkteve që përdorin minerale nga Komisioni AD HOC mbi Rentën Minerale” pika 1/1.*

#### **Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës per 2 nepunes civil:**

9. ■■■■■ me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor
10. ■■■■■ me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

*Për veprime në kundërshtim me kërkesat e veprime në kundërshtim me; Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “ Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë ” i ndryshuar, nenet 59,71, 115,*

116, 120; ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nenit 33/1; kërkesat e Manualit të Kontrollit miratuar me nr. 5045, datë 22.02.2011; Ligjin nr. 10304 datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” neni 40 pika 2, ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare”, ligjit nr. 10280, datë 20.05.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, VKM nr. 7, datë 04.01.2012 “Për Përcaktimin e Procedurave dhe të Dokumentacionit të Nevojshëm për Arkëtimin e Taksës së Rentës Minerale” pika 6 dhe 7, Shkresës së Ministrisë Financave nr. 16365 datë 17.10.2012 “Për Miratimin e Vlerave Referuese sipas Normativave Teknologjike të produkteve që përdorin minerale nga Komisioni AD HOC mbi Rentën Minerale” pika 1/1.

### **Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj per 1 nepunes civil:**

11. [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

*Për veprime në kundërshtim me kërkesat e veprime në kundërshtim me; Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “ Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë ” i ndryshuar, nenet 59,71, 115, 116, 120; ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nenit 33/1; kërkesat e Manualit të Kontrollit miratuar me nr. 5045, datë 22.02.2011; Ligjin nr. 10304 datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” neni 40 pika 2, ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare”, ligjit nr. 10280, datë 20.05.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, VKM nr. 7, datë 04.01.2012 “Për Përcaktimin e Procedurave dhe të Dokumentacionit të Nevojshëm për Arkëtimin e Taksës së Rentës Minerale” pika 6 dhe 7, Shkresës së Ministrisë Financave nr. 16365 datë 17.10.2012 “Për Miratimin e Vlerave Referuese sipas Normativave Teknologjike të produkteve që përdorin minerale nga Komisioni AD HOC mbi Rentën Minerale” pika 1/1.*

### **Shënim:**

- Për [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor Kukës, për të njëjtat shkelje të konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale e të trajtuara në Raportin përfundimtar, për periudhën e audituar viti 2013 dhe 2014 është marrë Vendimi i Komitetit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve nr. 1201, datë 25.07.2014 dhe shkresa nr. 10584, datë 27.11.2014.

- Për [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor Kukës, për të njëjtat shkelje të konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale e të trajtuara në Raportin përfundimtar, për periudhën e audituar viti 2013 dhe 2014 është marrë Vendimi i Komitetit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve nr. 1201, datë 25.07.2014 dhe nr. 235, datë 16.03.2015.

*Për sa më sipër nuk rekomandojmë masë disiplinore, pasi masa quhet e ezauruar.*

- Për 9 punonjës: [REDAKTUAR] të cilët janë atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për mangësi në zbatimin e detyrave funksionale, por në raste të veçanta, nuk rekomandohen masa disiplinore.

### **Ndërsa,**

Për [REDAKTUAR] me detyrë ish-Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor DRT Kukës dhe [REDAKTUAR] me detyrë ish- Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit DRT Dibër, shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” janë në nivelin e masës disiplinore neni 58, germa (c),”pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por që nuk janë rekomanduar, për arsye se ka shkëputur marrëdhëniet me institucionin.

## **E. RIAUDITIM ME AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË KLSH, NR. 286/7, DATË 31.07.2015**

Në fazën e Projekt Raportit të Auditimit, në bazë të autorizimit të Kryetarit të KLSH, me nr. 286/7, datë 31.07.2015, “Për verifikimin e dokumenteve dhe të dhënave financiare të subjektit “████████”, u verifikuan të dhënat e këtij subjekti dhe rezultoi se:

Për vitet 2013, 2014 sipas praktikës në sistemin e vjetër, subjekti ██████████, ka depozituar në mënyrë manuale jashtë sistemit, deklaratat mbi shitjet e inerteve për çdo muaj që i nënshtrohen taksës së rentës minerare dhe përlllogaritjen e taksës së rentës minerare për çdo muaj, në bazë të dy pasqyrave përmbledhëse, në shumën prej 4,544,259 lekë për vitin 2013 dhe në shumën prej 1,601,900 lekë për vitin 2014.

Për detyrimet në total për të dy vitet, 2013 & 2014, për subjektin ██████████ në shumën 8,261,657 lekë, nga Organi Tatimor është bërë hedhja në sistem e detyrimeve të deklaruara, së bashku me interesat dhe gjobat respektive, më datë 31.07.2015, pasi u paraqit autorizimi për riauditim nga KLSH.

**F.** Bazuar në rezultatet e Raportit të Kontrollit të Sigurimit të Cilësisë, u dha masë disiplinore “**vërejtje**” me **shkrim** në bazë të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, për 2 auditues te këtij grupi auditimi.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 132, datë 25.09.2015, është ngarkuar Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

**Shënim:** Auditimi u krye përgjatë periudhës 25.03.2015 deri më 20.07.2015, nga audituesit: Artan Mirashi, Aqif Klosi, Joniada Goçaj, Albert Thoma dhe Ina Sokoli, u mbikëqyr nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli si dhe në cilësinë e përgjegjëses së grupit të auditimit, u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, z. Ermal Yzeiraj dhe Drejtori i Përgjithshëm zj. Manjola Naço.

### **Mbi zbatimin e rekomandimeve:**

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Tiranë ende nuk është kthyer ende përgjigje për masat e marra në zbatim të rekomandimeve të lëna.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**